

INFORMATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Bashkë për një mjedis të shëndoshë dhe të sigurtë
Instrumenti:	Grante të vogla për projekte
Subjekti zbatues:	STOP Instituti për Menaxhim të Rrezikut nga Fatkeqësitë – IMRrF
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Ukë Bytyqi, p.n (ish kampi i KFOR-it gjerman, ndërtesa e kuqe pn), Prizren artnethaskuka@gmail.com +383 44 152 840
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/11/2025 Data e përfundimit: 30/06/2026
Buxheti total i grantit (EUR):	9,920.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	9,920.00 EUR
Grupet e synuara:	- Përfituesit e drejtëpërdrejtë – komuniteti, nxënësit dhe bizneset. - Përfituesit jo të drejtëpërdrejtë – komunat, ndërmarrjet publike, dhe OJQ-të mjedisore.
Shtrirja gjeografike:	Komunat Gjakovë dhe Rahovec
Përmbledhje e grantit:	Planet hapësinore të komunave të Gjakovës dhe Rahovecit dhe Plani i Menaxhimit të Pellgut të Lumit Drini i Bardhë, evidentojnë ndotjen dhe përmytjet si ndër sfidat kryesore mjedisore në këto territore. Këto probleme shkaktohen si nga faktorët natyrorë, ashtu edhe nga aktivitetet njerëzore, por dhe nga fakti që lumenjtë që rrjedhin në këto komuna i përkasin Pellgut të Lumit Drini i Bardhë që ka potencialin më të lartë të përmytjes në Kosovë. Siç u përmend më lartë njeriu është njëri nga faktorët kyç që kontribuon në shfaqjen këtyre dukurive, dhe kjo ndodh për shkak të i) mungesës së vetëdijes për pasojat në jetën, shëndetin, ekonominë dhe mjedisin, ii) përgjegjësisë për respektimin e kornizës ligjore dhe iii) njohurive për masat që mund të aplikohen për parandalimin dhe zbutjen e ndikimit apo rrezikut. Andaj, është e domosdoshme që komunitetet në zonat më të cenuara të informohen, vetëdijësohen dhe të inkurajohen të kontribuojnë në përmirësimin e situatës. Prandaj, për përmirësimin apo zbutjen e kësaj situatë, është propozuar projekti “Bashkë për një mjedis të shëndoshë dhe të sigurt” që synon të promovoj pjesëmarrjen aktive të komunitetit në zvogëlimin e

Bashkëfinancuar nga:

	ndotjes dhe përmbytjeve të lumenjve, përmes informimit dhe angazhimit gjithëpërfshirës. Për më tepër, projekti synon të forcojë bashkëpunimin dhe rritjen e transparencës e llogaridhënies ndërmjet palëve të interesit për ndërtimin e një mjedisi më të sigurtë dhe të qëndrueshëm, duke krijuar një model edhe për çështje të tjera që ndikojnë në përmirësimin e jetës së përditshme të qytetarëve, por gjithashtu edhe në arritjen e vizionit të Komunave dhe Agjendës 2030. Zbatimi i projektit pritet të sjellë rezultatet si në vijim: i) rritje të vetëdijes dhe angazhimit të komunitetit të zonave të cenuara të përzgjedhura në komunat Gjakovë dhe Rahovec për zvogëlim të ndotjes dhe rrezikut nga vërshimet, ii) rritje të vetëdijes së komunitetit të zonave të cenuara të përzgjedhura në komunat Gjakovë dhe Rahovec për dispozitat ligjore dhe rregullat komunale, si dhe vazhdim të dialogut dhe bashkëpunim të palëve të interesit. Këto rezultate do të arrihen përmes aktiviteteve të ndryshme si: takime, seminare, vizita në terren, video klip, trajnim të nxënësve të shkollave të mesme, si dhe shënimi i Ditës Ndërkombëtare Zero Mbeturina.
--	--